



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:276974  
Datë: 13.12.2023  
Numri i dokumentit: 05058267

**C – IV. – 15 – 0157**

**Paditësi :**

I D, nga Drenasi.

**Kundër**

**E paditura :**

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55 , Prishtinë.

**Për:** Palët ndërgjyqëse.

**Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, jashtë seancës gjyqësore, me dt.13.12.2023, nxjerr këtë:**

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET si e pa bazuar** kërkesëpadia e paditësit, av.I D, nga Drenasi, dhe Vendimi, PRN052-0017 i dt.11.01.2015 i Autoritetit të Likuidimit (AL) i Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, **VËRTETOHET si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

**II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

**Rrethanat Faktike dhe Procedurale:**

Me dt.16.02.2015, paditësi përmes postës, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (DhPGJSK), ka parashtruar kërkesë për rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, PRN052-0017 të dt.11.01.2015, e me të cilin, paditësit i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e tij për kompensim për përfaqësim të NSh "Ferronikeli" me seli në Glllogoc (në likuidim), në shumë prej 382.00 euro nga e duke u bazuar në nenin 36 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, dhe i cili parasheh se :” .... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ... dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese ...” e më gjerësisht si në arsyetimin e këtij Vendimi të AL-së.

Pala paditëse parashtresën e ka titulluar si “*kërkesë për rishikimin e vendimit*” mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Paditësi në këtë padi ka theksuar se në cilësinë e avokatit ka qenë i angazhuar për të përfaqësuar interesat e NSh, “Ferronikeli” me seli në Gllogoc, sipas padisë në lëndën SCC-05-0131, si palë paditëse ishte “RAD” nga Murgoshi, dhe për këtë çështje ka ndërmarr veprime përkatëse duke përgjigjur në padinë e paditësve sipas dispozitave të RREG/UNMIK që kanë rregulluar procedimin e çështjeve të tilla pranë Gjykatës Supreme të Kosovës- në Dhomën e Posaçme, për punën e bërë sipas Tarifës së Avokatëve, shuma e shërbimeve për secilin veprim për atë fazë ka arritur vlerën prej 88 euro, përkatësisht në shumë të përgjithshme prej 441.00 euro, dhe për këtë është paguar shuma prej 441.00 euro, ndërsa shuma totale arrin vlerën prej 823.00 euro, dhe pjesa e mbetur sipas listës për shpërbllim dhe shpenzime shuma prej 382.00 ende nuk është paguar. Kjo kërkesë pas 9 vitesh është refuzuar si e pavlefshme nga AL-ja në arsyet se nuk kishte informata dhe dëshmi të mjaftueshme për të mbështetur kërkesën mbështetur në nenin 36.2.2 të Ligjit, Nr.04/L-034 për AKP, duke theksuar më tej se kërkesa është ushtruar brenda aftait ligjor në pajtim me dispozitat ligjore të ligjit për AKP, me propozim që gjykata të pranoj dhe aprovoj kërkesën e kreditorit av. I D dhe të detyroj AKP-në, të bëjë pagesën e borxhi të në xhirollogarinë kreditorit dhe shpenzimet procedurale.

Paditësi kësaj padie i ka bashkangjitur kopje: kërkesën e avokatit dt. 03.08.2006, formularin e kërkesës, listën e shpërbllimit dhe shpenzimeve dt.08.06.06, shkresën e dt.08.06.2006 dhe vërtetim për dorëzim dokumenti, SCC-05-0131.

Me dt.18.10.2023, e paditura, AKP me seli në Prishtinë, ka parashtruar mbrojtje ndaj padisë së paditësit të parashtruar kundër Vendimit të AL-së, PRN052-0017 dt.11.01.2015, dhe se i përmbahet qëndrimin se autoriteti i Likuidimit, ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të saktë të dispozitave ligjore, duke pretenduar se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria i vendimit të AL, dhe se ankesat duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me nenin 74.2 të Ligjit Nr.04/L – 034 për AKP-në, dhe se vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitat ligjore dhe rrjedhimisht ankesa është e pabazuar dhe sipas nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, parashikon se “elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë ..... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”, dhe i paraqet gjykatës që t’a refuzoj si të pa pranueshme dhe të pa bazuar të ankesën e paditësit dhe t’a vërtetoj Vendimin e Autoritetit të likuidimit në pajtim me nenin 74.4 të Shtojcës së Ligjit, Nr.06/L – 086 dhe se kësaj mbrojtjeje, ia ka bashkëngjitur kopjen e Vendimit, PRN052-0017të dt.11.01.2015.

Me dt.19.10.2023, kjo gjykatë, me Urdhrin e saj, C – IV- 15 – 0157 të dt.19.10.2023, paditësit, ia ka adresuar mbrojtjen (përgjigjen) e të paditurës, dhe se pas pranimit të saj nga paditësi me dt. 3.10.2023 deri më tani nuk ka prova se i njëjti, ka paraqitur përgjigje në mbrojtjen e të të paditurës, AKP-së.

### **Arsyetimi ligjor:**

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji .

Në bazë të nenit 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”*

Po ashtu në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata merr aktgjykim pa caktuar seancës dëgjimore.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata, ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit av. I D nga Gllogovci, duhet të refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i kontestuar i Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN052-0017 dt.11.01.2015, duhet të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### ***Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditësit.***

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe ka konstatuar se NSh “Ferronikeli” me seli në Gllogoc, ka hyrë në procedurë të likuidimit me dt.04.07.2006, dhe se paditësi në procedurën e likuidimit tek AL-ja me dt. 07.08.2006, pra brenda afatit ligjor administrativ para AKP-së, e ka paraqitur kërkesën e tij me pretendimin për kompensim për përfaqësim të NSh “Ferronikeli” me seli në Gllogoc (në likuidim), në shumë të përgjithshme prej 823.00 €, gjegjësisht në shumën e mbetur të papaguar në shumë prej 382.00 € nga NSh, “Ferronikeli” me seli në Gllogoc (në likuidim) në lëndës, SCC – 05 – 0131, ku palë paditëses, ka qenë Ndërmarrja, “RAD” LLC kurse e paditur, ka qenë, NSh “Ferronikeli” me seli në Gllogoc por e cila kërkesë, nga AL-ja, me Vendimin e tij, PRN052-0017 të dt.11.01.2015, ishte refuzuar si e pa vlefshme derisa paditësi, pas pranimit të këtij aktvendimi në procedurën e likuidimit, pas dt.15.01.2015, kërkesë për rishikimin e vendimit kundër Vendimit të kontestuar të AL-së, PRN052-0017 dt.11.01.2015, pranë DHGJSK-së, e ka paraqitur me dt.16.02.2015 dhe atë përmes dërgimit me postë, pra brenda afatit ligjor prej 30 ditëve dhe se kërkesës/padisë së tij, paditësi, e ndaj të cilit është ngritur kërkesa – padia, nuk ia ka bashkëngjitur, Vendimin e AL-së, PRN052-0017 dt.11.01.2015 por se ky Vendim i AL-së, është pjesë e shkresave të lëndës, pasi që e paditura, me rastin e paraqitjes së mbrojtjes së saj në padinë e paditësit, ekzemplarin e Vendimit, PRN052- 0017 të dt.11.01.2015, ia ka bashkëngjitur kësaj mbrojtjeje.

Andaj, gjykata, ka vlerësuar se padia/kërkesa e paditësit për ri shikimin e Vendimit, i plotëson kriteret e pranueshmërisë nga dispozitat e nenit 35, 36 dhe nenit 74 Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në.

### ***Faktet kontestuese dhe jo kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.***

Gjykata gjen se në këtë rast paditësit nuk i është kontestuar se i njëjti ka përfaqësuar në emër të NSh “Ferronikeli” – në cilësinë e të paditurës, në çështjen juridike me paditësin, Ndërmarrjen, “R” me seli në M në lëndën SCC-05-0131, dhe se nuk është kontestuese se z. D, ka parashtruar kërkesën tek NSh “Ferronikeli” dhe tek AKP-ja për kompensim për përfaqësim në shumën e pretenduar prej 823.00 €, për të cilën nga vetë pohimi i z. D, se ka realizuar shumën prej 441.00 € në emër të përfaqësimit por si fakt kontestues për paditurën dhe gjykatën mbetet se paditësi me rastin e dorëzimit të kërkesës për kompensim për përfaqësim tek AL-ja, dhe se AL-ja nuk kishte gjetur informata dhe dëshmi të mjaftueshme në kërkesën e paditësit, dhe me dt.28.03.2014, AL-ja, i ka dërguar një letër parashtruesit përmes së cilën kërkon informata dhe dokumentacion shtesë në mbështetje të kërkesës së tij, gjegjësisht marrëveshjen e lidhur mes tij, si avokat dhe

NSh. “Ferronikeli” me seli në Gllogoc (në likuidim), e cila do të siguronte njohjen e tij si përfaqësues të NSh-së në seancat gjyqësore para DhPGJSK-së, si dhe detyrimin e NSh-së për pagesën totale në shumë prej 823.00 €, provë të dokumentuar se është paguar vetëm pjesërisht në shumën prej 441.00 € dhe çdo dokument të vlefshëm nëpërmjet të cilës NSh, i njej detyrimin në shumën e pretenduar prej 382.00 €, për të cilën parashtruesi në përgjigje e dt.31.03.2014, para AL-së, nuk ka sjell asnjërin nga dokumentet e kërkuara dhe se kërkesën e tij në procedurën e likuidimit, ia ka refuzuar si të pa vlefshme në kuptim të nenit 36 par.2 pika 2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në.

Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se kërkesa e paditësit, ka të bëjë me kërkesat e pa siguruara e të parapara në nenin 40 par.1 pika 1.6.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në e në të cilin, parashihet se : *“Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ...kërkesat e pasiguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”*.

Gjykata e vlerëson si të drejtë Vendimin e AL-së, PRN052-0017 të dt.11.01.2015, me të cilën është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit, e duke u bazuar në arsyet sipas nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, se në këtë rast ankuesit nuk i është kontestuar përfaqësimi i NSh-së në cilësinë e palës së paditur pranë DhPGJSK-së në çështjen juridike, SCC - 05-0131, por se për këtë përfaqësim duhet të dorëzonte marrëveshjen e lidhur mes tij dhe NSh “Ferronikeli”, për njohjen e tij si përfaqësues i saj për t’a përfaqësuar në seancat gjyqësore para DhPGJSK-së, si dhe detyrimin e NSh-së për pagesën totale në shumë prej 823.00 €, dhe provën të dokumentuar se është paguar vetëm pjesërisht në shumën prej 441.00 € dhe detyrimin në shumën e pretenduar prej 382.00 euro, për të cilën parashtruesi në përgjigje e dt. 31.03.2014, para AL-së nuk ka sjellë asnjërin nga dokumentet e kërkuara dhe ka refuzuar kërkesën, e për të cilën paditësi nuk i bënë të besueshme pretendimet e paraqitura, pasi që nuk paraqiti asnjë dokument - provë me të cilën do të dëshmonte se të njëjtit, i është mbetur borxh NSh-ja në shumën e pretenduar,

Paditësi edhe para gjykatës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi në kërkesën e tij që do të bënte të besueshme se kërkesa e parashtruesit nuk është vlerësuar drejtë nga AL-ja, me rastin e vendosjes, se baza e kërkesës dhe shuma e mjeteve të kërkuara në këtë procedurë duhet të mbështetet plotësisht me provat përkatëse të besueshme, pra, në këtë kuptim, ankuesja nuk ka arritur që të parashtrtojë prova në mbështetje të kërkesës së saj, dhe se gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e paditësit lidhur me të drejtën e tij në kompensim mbeten të pa argumentuara, andaj pretendimet e saj nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla është refuzuar si e pabazuar. Andaj gjykata konstaton se mbi bazën e fakteve të paraqitura të paditësit para AL-së dhe tani para gjykatës, nuk mund të marrë si të besueshme në aprovimin e kërkesës gjegjësisht ankesës së palës paditëse.

### ***Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës.***

Gjykata pas shqyrtimit të gjitha provava të cilat gjendjen në shkresat e lëndës, dhe pas konstatimit të gjendjes faktike, ka ardh në përfundimin dhe duke vlerësuar se qëndrimi i të paditurës i shprehur në Vendimin e kontestuar të AL-së, PRN 052 – 0017 të dt.11.01.2015, se kërkesa e paditësit për kompensim në emër të shpenzimeve të përfaqësimit të NSh “Ferronikeli” me seli në Gllogoc (në likuidim) në çështjen juridike, SCC - 05-0131, është refuzuar si e pavlefshme, është i drejtë, sepse është bazuar në obligimet e palëve në procedurë se në rastin kur pala pohon të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi, dhe pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën

e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësata apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese) dhe neni 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, parashikon se “*elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë ...dokumentacioni për kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese*” lidhur me nenin 42.3 i Ligjit nr. 06/L – 086, në mënyrë shprehimore citon se “*. Nëse pala e tillë dëshon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë*”. Andaj për shkak se pala paditëse, nuk ka sjell provën gjegjëse, pra marrëveshjen eventuale të lidhur mes tij, si avokat dhe NSh “Ferronikeli” me seli në Glllogoc (në likuidim) për njohjen e tij si përfaqësues i saj për t’a përfaqësuar atë në seancat gjyqësore para DhPGJSK-së në çështjen juridike, SCC – 05 - 0131, e për më tepër, kjo kërkesë është dashur të vendoset në çështjen juridike, SCC – 05 - 0131 si dhe në këtë çështjen juridike, pa kërkesë kryesore, nuk mund të zhvillohet procedura e ndarë për çështjen e shpenzimeve procedurale, siç edhe ka kërkuar pala paditëse në kërkesën e saj për ri shikimin e Vendimit të AL-së, PRN052 - 0017 të dt.11.01.2015, andaj edhe e refuzoj si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, av.ID, nga Drenasi për kompensimin e shpenzimeve në emër të përfaqësimit të NSh “Ferronikeli” me seli në Glllogoc (në likuidim), në shumën prej 382.00 euro dhe Vendimi, PRN052-0017 i dt.11.01.2015 i Autoritetit të Likuidimit (AL) i Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, duhet të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të jap arsyetime tjera ligjore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK).

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), gjykata vendosi që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

## **DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2022:276974, 13.12.2023**

**Gjykatësi,  
Agron Hoxhaj**

### **KËSHILLË JURIDIKE :**

Kundër këtij aktgjykimi, mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).